



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "DLD Group shpk" të datës 21.08.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e aparaturave për printim, kopjim, skanim, furnizimi i tyre me toner, drum si dhe ngjyra me plotter - Mirëmbajtja e E-Kiosqeve - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-5328-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "DLD Group shpk" të datës 21.08.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e aparaturave për printim, kopjim, skanim, furnizimi i tyre me toner, drum si dhe ngjyra me plotter - Mirëmbajtja e E-Kiosqeve - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-5328-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "DLD Group shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 21.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e aparaturave për printim, kopjim, skanim, furnizimi i tyre me toner, drum si dhe ngjyra me plotter - Mirëmbajtja e E-Kiosqeve - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-5328-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "DLD Group" SH.P.K" është eliminuar me arsyetimin se kinse, ka mospërputhje në listën e kontratave dhe referencës mirëpo, në rastin konkret është përojedhur një gabim teknik nga ana OE dhe se referenca është vërtetuar nga ARC dhe ky shkak për eliminim nuk mund të qëndroj. Dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik me plotësim ndryshimet, i japin të drejtë Autoritetit të Konkurrencës që në çdo kohë dhe në çdo fazë të procedurës, të kërkojë me shkrim nga një tenderues, që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij për të sqaruar ndonjë fakt dhe po ashtu mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Si arsye tjetër e eliminimit është se, OE nuk i plotëson ISO standardet e kërkuara përkatësisht nuk janë paraqitur certifikatat ISO 27001 dhe ISO 14764 mirëpo edhe këtu AK gabimisht i ka vlerësuar rrethanat e rastit sepse pajisjet për të cilat është hapur tenderi, janë pajisje të cilat vite me parë i ka prodhuar - "DLD Group" SH.P.K" dhe të eliminohet për këtë shkak, është non sens i llojit të vetë. Arsyeja tjetër e eliminimit përmendet mos përmbushja e kriterëve për menaxhimin e projektit sepse Kujtim Krasniqi nuk e ka përgatitjen profesionale dhe përvojën profesionale të përcaktuara sipas kushteve dhe kriterëve për dhënien e kontratës mirëpo edhe në këtë pikë gjendja faktike është ndryshe nga ajo që është pasqyruar nga Autoriteti Kontraktues sepse certifikatat e kërkuara nga AK janë të nevojshme për developerin i cili do të merret me krijimin e aplikacionit dhe të gjitha këto kushte apo kriterë i plotëson programeri z. Gazmend Mehmeti. Sa i përket kriterit tjetër mungesës së CV, letër referencës përfshirë detajet e projekteve dhe kontratave, mungesa e certifikatave, i cili ka quar në eliminimin e ankuesit "DLD Group" SH.P.K" janë me tepër parafrazime të përgjithësuara të AK të cilat janë në kundërshtim me provat e dorëzuara nga OE e të cilat gjenden në dosje. Z. Gazmend Mehmeti është developeri i OE "DLD Group" SH.P.K" që nga fillimi dhe i cili e kishte krijuar programin të cilin e kishte përdorur më herët Komuna e Prishtinës dhe nuk ka pasur probleme në krahasim me kompaninë e cila është zgjedhur fituese prandaj, edhe ky pretendim i AK si gjithë të tjerët, nuk qëndron. Edhe kriteri tjetër në të cilin thirret AK – Komuna e Prishtinës se kinse nuk është përmbushur kriteri për Ekspertin e Zhvillimit të Softuerit në Ueb është abstrakt, i pa mbështetur në prova dhe si i tillë jo ligjore për faktin se, aftësimin e këtij hardware deri me sot ka arritur ta bëjë vetëm "DLD Group" SH.P.K", pasi që pjesët e brenda >E-Kioskes janë pjesë të cilat i ka vendosur ankuesi dhe është prodhues i saj.. Kur ishte hapur tenderi I parë, ishte si kusht update i pajisjes të pranimit të monedhave metalike në versione të reja që të mos kaloj monedha fallce mirëpo, kur është bërë ritenderimi, ky kusht është larguar. Një gjë është më së e sigurtë se, OE fitues nuk i plotëson as kushtet minimale dhe është e pa aftë të bëjë përditësimin e kësaj paisje, gjë që pashmangshëm të qon tek dyshimi se AK – Komuna e Prishtinës, me rastin e ritenderimit i ka ndryshuar kushtet më qëllimin e vetëm që ti përshtaten këto kusht kompanisë fituese".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Ju njoftojmë se oferta juaj është refuzuar për arsyet në vijim:

kjo oferte rezulton e papërgjegjshme për arsyet se Operatori Ekonomik me ofertën e tij nuk ka dorëzuar sipas kërkesës së DT-se dhe njoftimit për kontratë, prandaj oferta juaj është vlerësuar si e papërgjegjshme, për këto arsyeje:

- Mos përputhje në listën e kontratave dhe referencën

Në listën e kontratave (sipas Aneksit 7) figuron se kontrata "Furnizim me pajisje MCDM (Money Card Document Machine) për nevojat e ARC" është nënshkruar më datë 20.12.2022, ndërsa në referencë figuron data 08.12.2022 (data e lëshimit të referencës për punët e kryera).

- Mungesë dokumentacioni të detyrueshëm

Nuk janë paraqitur certifikatat ISO 27001 dhe ISO 14764.

- Mos përmbushje e kriterëve për Menaxherin e Projektit (Kujtim Krasniqi)

Nuk ka diplomë Masteri.

Nuk ka përvojë pune 10-vjeçare pas diplomimit në nivelin Bachelor (është diplomuar në vitin 2019).

- Mungon CV-ja, mungon letra e referencës së plotë me të gjitha detajet e projekteve dhe kontratat për verifikimin e punëve të përfunduara, nuk janë paraqitur certifikatat:

Developing ASP.NET MVC Web Applications (Microsoft)

Professional Scrum Master (PSM)

- Mos përmbushje e kriterëve për Ekspertin e Zhvillimit të Softuerit në Ueb

Personi i propozuar: Gazmend Mehmeti (i cili është paraqitur edhe si ekspert për Data baza).

Nuk ka përvojë pune 10-vjeçare pas diplomimit në nivelin Bachelor (është diplomuar në vitin 2017).

Diploma nuk është e noterizuar.

- Mungon linku për verifikim të certifikatave:

Microsoft Certified Database Administrator

Microsoft Certified Solution Developer.

Megjithatë, me keqardhje ju njoftojmë se oferta nuk është përzgjedhur fituese, sipas kushteve dhe kriterëve për dhënien e kontratës.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi parimisht as nuk i konteston fare arsyet për të cilat është eliminuar oferta e tij si e papërgjegjshme por më tepër aludon se këto gabime në ofertën e tij nuk janë relevante. Sidoqoftë pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 27.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.